



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 633/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Bardha Gashi, anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bardha Gashi, anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Suharekë, me shenjën ZL.Anr.633/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel ZL.Anr.633/2017 me datën 09.11.2017, nga Bardha Gashi, anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë, nga radhët e subjektit politik AAK, në të cilën thekson se i mungojnë votat në këto vendvotime: 2419A/01R, 2419A/02D, 2404A/02D 2401A/02R, 2422A/01R, 2429A/01D, 2415A/02D, 2410A/01R, 2410A/02D, 2420A/02D dhe 2420A/01R.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se gjatë hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me datë 11.11.2017 në kutitë e votimit: 2419A/01R, 2419A/02D, 2404A/02D 2401A/02R, 2422A/01R, 2429A/01D, 2415A/02D, 2410A/01R, 2410A/02D, 2420A/02D dhe 2420A/01R, në QNR, konstatoi se në vendvotimet 2419A/01R, 2419A/02D, 2404A/02D 2401A/02R, 2422A/01R, 2429A/01D, 2415A/02D, 2410A/01R, 2410A/02D, 2420A/02D dhe 2420A/01R në QNR nuk

ka pasur ndryshim te votave nga numri i votave te shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017 .

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtruesit të apelit sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qëndrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.633/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuese e Panelit**  
Gyltene Sylejmani



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*